



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.03.2023

Nr: 33

Ora: 13:00

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 36 TË SUBJEKTIT ANKUES “PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryetari z. Sali Berisha

PALË E INTERESUAR: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa

OBJEKT: 1. Kundërshtim i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 179, datë 18.03.2023

2. Ndryshimi i këtij vendimi, duke vendosur: Pezullimin e regjistrimit të subjektit “Partia Demokratike” me nënkryetar z. Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, deri kur Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim përfundimtar për ankimimin e subjektit “Partia Demokratike e Shqipërisë” e përfaqësuar nga Kryetari z. Sali Berisha

BAZË LIGJORE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 123/1, 124, 133-136, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe shkronja “b”, pika 1, të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
2. Partia Demokratike e Shqipërisë, nëpërmjet z. Indrit Sefa, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesë për regjistrimin e Partisë Demokratike me nr. 1337 Prot, datë 6.3.2023 nga zoti Indrit Sefa, përfaqësues i kësaj partie në KQZ, i autorizuar për paraqitjen e kërkesës nga kryetari Lulzim Basha.
3. Z. Sali Berisha ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me nr. 1329 prot, datë 5.3.2023, për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen në datën 14 maj 2023.

4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me anë të vendimit nr. 172, datë 14.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratike” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, vendosi “mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të “Partisë Demokratike” me kryetar z. Lulzim Basha, me shkronjat nistore “PD” ose “PDSH” me arsyetimin se akti autorizues për personin që ka paraqitur kërkesën për regjistrim të Partisë Demokratike, ashtu edhe Deklarata e Angazhimit Solemn e kryetarit të Partisë Demokratike z. Lulzim Basha nuk përmbushin kërkesat e nenit 64 të Kodit Zgjedhor.
5. Kundër këtij vendimi paraqitën kërkesa ankimore Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa dhe Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Sali Berisha.
6. Pas shqyrtimit bashkërisht të dy kërkesave ankimore, KAS, me vendimin nr. 27, datë 16.03.2023, vendosi:
- “1. Rrëzimin e kërkesës ankimore me nr. 33 të ankuesit “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri;*
- 2. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 32 të ankuesit “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa;*
- 3. Detyrimin e partisë “Partia Demokratike”, të depozitojë në KQZ dokumentacionin shtesë si më poshtë vijon:*
- Deklaratën sipas shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 64 të Kodit Zgjedhor me të dhënat për nënkryetarin z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;*
 - “Deklaratën e angazhimit solemn” të nënshkruar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë.*
- 4. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e Komisionerit të regjistrojë subjektin zgjedhor “Partia Demokratike” me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë”.*
7. Pas vendimmarrjes së sipërcituar të KAS dhe pas plotësimit të dokumentacionit përkatës nga z. Enkelejd Alibeaj, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 179, datë 18.03.2023 vendosi

“regjistrimin e partisë politike “Partia Demokratike”, me shkronja nistore “PDSH”, me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

8. Gjatë seancës së kësaj vendimmarrjeje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përfaqësuesi i Partisë Demokratike z. Franci Nuri, i ka kërkuar Komisionerit pezullimin e kësaj vendimmarrjeje meqenëse kjo palë i ishte drejtuar Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit në zbatim të nenit 145 të K.Zgjedhor në lidhje me vendimin e KAS nr. 27, datë 16.03.2023. Komisioneri rezulton që mos ta ketë argumentuar në vendimin nr. 179, datë 18.03.2023 mospranimin e kësaj kërkesë si në arsyetim ashtu dhe në dispozitiv.
9. Për sa më sipër, Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga z. Sali Berisha, me anë të kërkesës ankimore nr. 36, depozituar në KQZ në datë 20.03.2023, ka kundërshtuar vendimin nr. 179, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
10. Në seancën e datës 21.03.2023, KAS, pasi ka shqyrtuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të kësaj kërkesë ankimore, me vendimin nr. 312, datë 21.03.2023 ka vendosur:
“ 1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 36, datë 20.03.2023, të paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 23.03.2023, ora 13:00.”
11. Në këtë shqyrtim administrativ, në zbatim të nenit 133 pika 1 shkronja “b”, mori pjesë si palë e interesuar dhe partia politike “Partia Demokratike e Shqipërisë” e përfaqësuar nga z. Indrit Sefa dhe z. Rezart Kthupi.
12. Ankimuesi, në ankim dhe në parashtrimet e tij pranë KAS pretendoi ndër të tjera se:
 - Në bazë të nenit 158 të K.Zgjedhor, në kushtet kur Kolegji Zgjedhor do të shprehet brenda afateve të caktuara nga ligji për ankimin në lidhje me vendimin e KAS nr. 27, datë 16.03.2023, si dhe sa kohë Kolegji Zgjedhor mund të vendosë potencialisht të pranojë padinë dhe të prishë vendimin e KAS, gjykojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kishte detyrimin që të pezullonte zbatimin e vendimit nr. 27, datë 16.03.2023, objekt ankimi në Kolegjin Zgjedhor,

derisa ky i fundit të shprehet me vendim përfundimtar;

- K.Zgjedhor në tërësinë e tij, por as në veçanti neni 21 i tij (dispozitë kjo që trajton kompetencat e KAS), nuk parashikon në asnjë moment se vendimmarrjet e KAS të jenë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme menjëherë. Përkundrazi, neni 158 i K.Zgjedhor që trajton llojet e vendimmarrjeve të Kolegjit Zgjedhor, parashikon se vendimi i Kolegjit “është i formës së prerë. Ndaj tij nuk bëhet ankim”, çka nënkupton se *a contrario*, vendimet e KAS nuk janë të formës së prerë;
- Rrjedhimisht, nga arsyetimi i KSHZ në seancën publike të datës 18.03.2023 nuk shohim asnjë arsye përse nuk duhej pritur vendimi i Kolegjit Zgjedhor për këtë çështje. Kjo praktikë është e bazuar në ligj si dhe në precedentët e mëparshëm të gjykuar nga vetë Kolegji Zgjedhor në të shkuarën;
- Prandaj, për të mos paragjykuar besueshmërinë e procesit zgjedhor, të gjitha palët duhet të kishin pritur me qetësi vendimmarrjen e Kolegjit Zgjedhor, përpara se të planifikonin seancën për regjistrimin e PD në zgjedhje; dhe si përfundim kërkuan
- Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 179, datë 18.03.2023 dhe ndryshimin e këtij vendimi duke vendosur pezullimin e regjistrimit të subjektit “Partia Demokratike” me nënkryetar z. Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 majit 2023 dhe pezullimin e të gjithë veprimtarive që rrjedhin si pasojë e këtij regjistrimi si subjekt zgjedhor deri kur Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim përfundimtar për ankimin e subjektit “Partia Demokratike e Shqipërisë” e përfaqësuar nga Kryetari z. Sali Berisha.

13. Pala e interesuar, Partia Demokratike e Shqipërisë, në prapësimet e saj argumentoi se kjo kërkesë ankimore është e pabazuar në K.Zgjedhor dhe në K.Pr.Administrative pasi vendimmarrjet e KAS janë të ekzekutueshme pavarësisht ankimit që pala i ka drejtuar Kolegjit Zgjedhor, e për rrjedhojë duhet rrëzuar dhe duhet lënë në fuqi vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

14. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ, po ashtu prapësoi se kërkesa ankimore është e pabazuar në ligj dhe në prova e për rrjedhojë duhet rrëzuar dhe duhet lënë në fuqi vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-I konstatoi

1. Si fillim është e rëndësishme të trajtohet procedura e ndjekur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve deri në vendimmarrjen objekt i këtij shqyrtimi administrativ.
2. Procedura administrative ka nisur me dy kërkesa në zbatim të neneve 64 dhe 123/1 të K.Zgjedhor, më konkretisht:
 - Partia Demokratike e Shqipërisë, nëpërmjet z. Indrit Sefa, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesë për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, me nr. 1337 Prot, datë 6.3.2023 nga zoti Indrit Sefa, përfaqësues i kësaj partie në KQZ, i autorizuar për paraqitjen e kërkesës nga kryetari Lulzim Basha; dhe
 - Z. Sali Berisha ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me nr. 1329 prot, datë 5.3.2023, si kryetar i Partisë Demokratike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen në datën 14 maj 2023.
3. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të dy kërkesave të sipërcituara, Komisioneri, me anë të vendimit nr. 172, datë 14.03.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës së "Partisë Demokratike" për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023", vendosi "*mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të "Partisë Demokratike" me kryetar z. Lulzim Basha, me shkronjat nistore "PD" ose "PDSH"*
4. Pas kësaj vendimmarrje, në zbatim të neneve 124 e vijues të K.Zgjedhor, të dyja palët kërkuese, ju drejtuan KAS me kërkesa ankimore për kundërshtimin e vendimit të Komisionerit dhe regjistrimin si subjekt zgjedhor të palëve që ato përfaqësonin respektivisht.
5. KAS, pas shqyrtimit administrativ bashkërisht të kërkesave ankimore, mori vendimin nr. 27, datë 16.03.2023 i cituar në hyrje të këtij vendimi.

6. Pas vendimmarrjes së sipërcituar të KAS dhe pas plotësimit të dokumentacionit përkatës nga z. Enkelejd Alibeaj, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 179, datë 18.03.2023, vendosi *“regjistrimin e partisë politike “Partia Demokratike”, me shkronja nistore “PDSH”, me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”*.
7. Është pikërisht kjo vendimmarrje që është ankimuar, pasi sipas ankimesit vendimi nr. 27, datë 16.03.2023 nuk është i ekzekutueshëm për aq kohë sa Kolegji Zgjedhor nuk është shprehur në lidhje me ankimin gjyqësor që pala ankimuese ka depozituar ndaj atij vendimi. Pala ankimuese, ekzekutimin e aktit administrativ, vendimi nr. 27, datë 16.03.2023 të KAS, e lidh me marrjen e tij formë të prerë, pra i konsideron si një institut pavarësisht se bëhet fjalë për dy juridiksione të ndryshme, më konkretisht procedurat e ndjekura pranë Komisionerit dhe pranë KAS janë pjesë e juridiksionit administrativ, ndërkohë që procedura e ndjekur pranë Kolegjit Zgjedhor i përket juridiksionit gjyqësor.
8. **Në lidhje me ekzekutueshmërinë e akteve administrative të organeve të KQZ, përveç atyre që janë akte administrative që përmbajnë dënime administrative me gjobë dhe për të cilat K.Zgjedhor parashikon në nenin 176 të tij se *“Gjoha e vendosur nga KQZ-ja, sipas kësaj pjese, përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas procedurave të parashikuara në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile”, na duhet t’i referohemi K.Pr.Administrative dhe më konkretisht neneve 164 e vijues të tij.***
9. Neni 164 i K.Pr.Administrative, në lidhje me aktin administrativ të ekzekutueshëm, parashikon se:
- “1. Akti administrativ mund të ekzekutohet vetëm pasi ka hyrë në fuqi.***
- 2. Akti administrativ fillon të ekzekutohet:***
- a) pas përfundimit të afatit të ankimit administrativ, nëse nuk është bërë ankim;***
- b) pas njoftimit të aktit administrativ, në qoftë se ankimi administrativ nuk lejohet;***
- c) pas njoftimit të aktit administrativ, në qoftë se, sipas ligjit, ankimi administrativ nuk ka efekt pezullues;***
- ç) pas njoftimit të vendimit për heqjen e efektit pezullues të ankimit, në përputhje me nenin 133 të këtij Kodi;***

d) pas njoftimit të vendimit që zgjidh ankimin, nëse ky i fundit e ka refuzuar apo nuk e ka pranuar apelimin.

3. Vendimi organit publik, i cili ndryshon aktin e ankimuar, bëhet i ekzekutueshëm pasi i njoftohet palës”.

10. Neni 166 i K.Pr.Administrative, në lidhje me aktet administrative që nuk mund të ekzekutohen, parashikon se:

“Përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, akti administrativ i ekzekutueshëm, sipas nenit 164, të këtij Kodi, nuk ekzekutohet nëse:

a) efekti i i tij është pezulluar në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) kundër tij është bërë një ankim me efekt pezullues;

c) kanë kaluar 5 vjet nga data në të cilin akti është bërë i ekzekutueshëm”.

11. Neni 133 i K.Pr.Administrative, në lidhje me efektet e ankimit administrativ ndaj aktit administrativ, parashikon se:

“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi administrativ ndaj aktit, i paraqitur në përputhje me kërkesat e neneve 130-132, të këtij Kodi, pezullon ekzekutimin e aktit deri në njoftimin e vendimit të ankimit.

2. Nëse në aktin administrativ përfshihen dy ose më shumë palë me interesa të njëjtë, ankimi administrativ ndaj aktit të paraqitur nga njëra nga palët, i shtrin efektet e pezullimit ndaj të gjitha palëve të përfshira.

3. Zbatimi i aktit administrativ ndaj aktit nuk pezullohet kur:

a) akti administrativ synon mbledhjen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera buxhetore;

b) akti administrativ ka të bëjë me masa policore;

c) organi publik, i cili shqyrton ankimin, vlerëson se zbatimi i menjëhershëm është në interes të rendit publik, shëndetit publik dhe të interesave të tjerë publikë.

4. Kundër aktit që vendos ndalimin e efektit pezullues të ankimit, mund të bëhet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatën kompetente për çështjet administrative, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit”.

12. Duke ju rikthyer rastit objekt shqyrtimi administrativ, theksojmë se si vendimet e

Komisionerit, ashtu dhe ato të KAS, janë akte administrative që hyjnë në fuqi menjëherë. Vendimi i Komisionerit nr. 172, datë 14.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratike” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, duke qenë se është ankimuar nga të dyja palët që kanë qenë pjesë e procedurës administrative, në zbatim të nenit 133 pika 1 e K.Pr.Administrative, e ka pezulluar ekzekutimin e këtij akti administrativ, por më tej KAS me vendimin nr. 27, datë 16.03.2023, ka ndryshuar aktin administrativ të ankimuar, çka në zbatim të nenit 164 pika 3 të K.Pr.Administrative është dhe momenti kur akti administrativ bëhet i ekzekutueshëm, pra pasi i njoftohet palës.

13. Pala ankimuese, dështoi që të argumentonte nëse kërkesa e tyre për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të KAS nr. 27, datë 16.03.2023 të ishte në kushtet e parashikimeve të nenit 166 të K.Pr.Administrative që përcakton rastet e akteve që nuk mund të ekzekutohen, pasi nuk plotësohet asnjë prej kushteve që kërkohen nga kjo dispozitë. Më konkretisht, K.Zgjedhor nuk parashikon në asnjë dispozitë të tij pezullimin e efekteve të vendimeve të KAS në rast ankimimi të tyre në juridiksionin gjyqësor (neni 166 shkronja “a” e K.Pr.Administrative). Po ashtu, ndaj vendimmarrjes së KAS, K.Zgjedhor nuk parashikon ndonjë ankim me efekt pezullues pasi vetë KAS është hallkë ankimimi administrativ, ndaj nuk jemi as në kushtet e shkronjës “b” të nenit 166 të K.Pr.Administrative. Po ashtu, nuk jemi as në kushtet e shkronjës “c” të nenit 166 të K.Pr.Administrative pasi vendimi i KAS është ekzekutuar brenda 2 ditëve nga dita që ai është bërë i ekzekutueshëm.
14. Për sa më sipër arsyetuar, duke qenë se vendimi i KAS nr. 27, datë 16.03.2023 është një akt administrativ që është i ekzekutueshëm me njoftimin e tij, atëherë, në zbatim të nenit 167 të K.Zgjedhor që parashikon se *“Përveçse kur ligji parashikon shprehimisht një organ tjetër, ekzekutimi i detyrueshëm është në kompetencën e organit publik që ka nxjerrë aktin fillestar, pavarësisht nëse ai është ndryshuar apo zëvendësuar nga organi epror, si pasojë e ankimit administrativ, apo nga gjykata”*, ekzekutimi është në kompetencën e Komisionerit, i cili pas këtij vendimi nuk është më në kushtet e ushtrimit të diskrecionit për ta pezulluar apo jo ekzekutimin e këtij akti administrativ, në kuptimin që nuk e gëzon të drejtën për hapësirë vlerësimi nëse mund ta pezullojë apo jo ekzekutimin e vendimmarrjes së KAS.

15. Pala ankimuese dështoi gjithashtu të përcaktonte dëmin që i vinte nga ekzekutimi i vendimit të KAS nr. 27, datë 16.03.2023 edhe në rastin hipotetik që Komisioneri apo KAS do ta kishin hapësirën procedurale për pezullimin e këtij akti administrativ.
16. Gjithashtu, pala ankimuese ju përgjigj negativisht pyetjes nëse i kishte kërkuar Kolegjit Zgjedhor pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ vendim i KAS nr. 27, datë 16.03.2023, meqenëse është pikërisht ky akti i cili është ankimuar gjyqësisht.
17. Lidhur me konstatimin e faktit se Komisioneri nuk ka reaguar me vendim për kërkesën e ankuesit me objekt *“pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 27, datë 16.03.2023 të KAS-it”*, çmujmë se kërkesat procedurale të palëve të përfshira në proces duhet të marrin përgjigje procedurale në një shqyrtim administrativ. Kjo do të thotë që Komisioneri duhet të kishte argumentuar dhe rrëzuar kërkesën për pezullim kur vendosi zbatimin e vendimit nr. 27, datë 16.03.2023 të KAS-it. Gjithsesi kjo e metë procedurale e ngritur si pretendim në seancën e shqyrtimit administrativ nga ankuesi nuk ka lidhje me objektin e kërkesës ankimore. Vetë ankuesi nuk mbështeti ndonjë kërkim mbi këtë pretendim. Për këtë arsye KAS-i nuk mund ta çojë përtej konstatimit analizën e tij rreth këtij pretendimi.
18. Për sa më sipër, KAS e konsideron haptazi të pabazuar në ligj kërkesën ankimore objekt i këtij shqyrtimi administrativ dhe për rrjedhojë vendimi nr. 179, datë 18.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 30, pika 1, shkronja “b”, të Vendimit nr. 3/2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, KAS-i me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 36, datë 20.03.2023 të paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë, me përfaqësues z. Sali Berisha;
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 179, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mbi zbatimin e vendimit nr. 27, datë 16.3.2023, të Komisionit të Ankimeve

dhe Sanksioneve, për regjistrimin e “Partisë Demokratike” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”;

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ledio BRAHO	-	Relator	
Elvin LAKO	-	Anëtar	
Elvis ÇEFA	-	Anëtar	(Kundër)
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar	
Koli BELE	-	Anëtar	